

Më  
Data

18 / 06 / 2018

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal,** Gjyqtari i vetëm gjykues Hakile Ilazi, me zyrtaren ligjore Ganimete Avdiu, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDAKTUAR] nga Fshati [REDAKTUAR], Komuna e Ferizajit, për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par. 1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.2242-5/17, e dt. 18.12.2017, duke vendosur lidhur me kërkesën e PTH-së në Ferizaj, për dhënien e urdhrin ndëshkimor, më dt. 10.04.2018, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e PTH-së në Ferizaj, PP.nr.2242-5/17, e dt. 18.12.2017, dhe kjo gjykatë lëshon:

**URDHËR NDËSHKIMOR**

**I pandehuri:**

[REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj, i lindur më [REDAKTUAR] në fshatin [REDAKTUAR] K. Ferizaj, nga i ati [REDAKTUAR] i papunësuar, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

**S e p s e:**

Me dt. 04.10.2017 rreth orës 16:50 në pyllin shoqërorë të cilin e menaxhon Drejtoria për buqësi dhe pylltari në Ferizaj, në rajonin ekonomik pyjor në fsh.Neredime-Jezercë në vendin e quajtur "Te quku i dardhës", me qëllim vjedhje ka prerë 3 copë drunjë të llojit ahut me diametër 30-40cm në gjatësi Boniteti –III gjithsejtë në karburantë prej 2.08<sup>3</sup>, vlera e dëmit të shkaktuar është 280.80Euro, të cilat drunjë i ka bartur me traktor IMT-539.

- me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par. 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 4,7,17,23,41,46,73, të KPRK-së si dhe nenit 495, të KPPK-së:

### **DËNIM ME GJOBË**

Ashtu që i përcakton dënim në lartësi prej 200€ (dyqind/euro), të cilin dënim obligohet ta paguaj brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgimi ashtu që për çdo 20€ (njëzet/euro) të papaguara do t'i llogaritet 1 (një) ditë burg.

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve paushalle të paguaj shumën prej 20€ (njëzet/euro), brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Detyrohet i pandehuri që për kompensimin e Viktimave të Krimit obligohet ta paguaj shumën prej 30€ (tridhjetë/euro), brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara Agjensioni Pyjor i Kosovës-Zyra në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

### **A r s y e t i m i**

**Prokuroria Themelore Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm**, me aktakuzën, PP. nr.2242-5/17, e dt. 18.12.2017, ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR] nga Fshati [REDAKTUAR], KK Ferizaj, për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par. 1 të KPRK-së, dhe njëherit gjykatës i ka kërkuar edhe dhënien-lëshimin e urdhit ndëshkimorë, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal dhe shkresat tjera të lëndës, lidhur me arsyeshmërinë e aktakuzës në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri vërtet ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata duke shqyrtuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës, vlerëson se ka prova të besueshme, lidhur me bazueshmërinë e Aktakuzës në drejtim të vërtetimit të fakteve dhe atë: fletëparaqitja e rojeve të pyjeve e datës 11.10.2017 dhe procesverbali i datës 11.10.2017, ku erdhi në përfundim se i pandehuri vërtet e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, prandaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 495 të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPPRK-së dhe konform nenit 495 par. 1 të këtij kodi mori vendim që të pranoj propozimin për dhënien e urdhrin ndëshkimorë, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor.

Mundësia e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burgim është marr në kuptim të nenit 46 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.


Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ,**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal**  
**P.nr.3248/17 e dt. 10.04.2018**

**Zyrtarja ligjore**  
Ganimete Avdiu

**Gjyqtarja**  
Hakile Ilazi



**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, gjyqtarit individual të kësaj gjykate. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhri ndëshkimorë merr formën e prerë.